LIGJ
Nr.9299, datë 28.10.2004

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË VENDIMIN III/1, AMENDAMENT I KONVENTËS SË BAZELIT "PËR LËVIZJEN NDËRKUFITARE TË MBETJEVE TË RREZIKSHME DHE ASGJËSIMIN E TYRE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Vendimin III/1, amendament i Konventës së Bazelit "Për lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4398, datë 17.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIMI III/1
AMENDAMENT I KONVENTËS SË BAZELIT

Konferenca,

duke rikujtuar se në takimin e parë të Konferencës së Palëve të Konventës së Baselit u shtrua një kërkesë për ndalimin e transportimit të mbetjeve të rrezikshme prej vendeve të idustrializuara për vendet në zhvillim;

duke rikujtuar vendimin II/12 të Konferencës,

duke vënë në dukje se:

- Grupi teknik i punës është instruktuar prej kësaj Konference për të vazhduar punën e saj mbi karakterizimin e rrezikshmërisë së mbetjeve që janë subjekt i Konventës së Baselit (vendimi III/12);

- Grupi teknik i punës ka filluar tashmë punën e tij për përmirësimin e listave të mbetjeve që janë të rrezikshme dhe mbetjeve që nuk janë subjekt i kësaj Konvente;

- Ato lista (dokumenti UNEP/CHW.3/Inf.4) japin udhëzime të rëndësishme, por nuk janë të kompletuara apo të pranuara plotësisht;

- Grupi teknik i punës do të përgatisë udhëzime teknike për të asistuar çdo palë ose shtet që ka të drejtën të përfundojë marrëveshje ose rregullore, përfshirë ato sipas nenit 11 në lidhje me lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme.

1. Instrukton grupin teknik të punës që t'i jepet prioritet të plotë kompletimit të punës për karakterizimin e rrezikshmërisë së mbetjeve dhe përmirësimit të listave dhe udhëzuesve teknikë në mënyrë që t'i paraqesë ato për miratim në takimin e katërt të Konferencës së Palëve;

2. Vendos që Konferenca e Palëve do të marrë në takimin e katërt të saj një vendim mbi një/disa lista;

3. Vendos të adaptojë amendamentet e mëposhtme të Konventës:

"Futja e paragrafit të ri hyrës, 7 bis:

Duke pasur parasysh se lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme, sidomos për vendet në zhvillim, rrezikojnë të mos marrin parasysh administrimin e drejtë mjedisor të mbetjeve të rrezikshme,

ashtu sikundër është kërkuar nga kjo Konventë”

Futja e nenit të ri 4A:

1. Çdo Palë e listuar në aneksin VII duhet të ndalojë të gjitha lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme që janë të destinuara për veprime sipas aneksit IV/A për në shtetet që nuk janë të listuara në aneksin VII.

2. Çdo Palë e listuar në aneksin VII duhet të heqë nga përdorimi prej datës 31 dhjetor 1997 dhe ndalohet që nga kjo datë të gjitha lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme sipas nenit 1 paragrafi 1(a) të Konventës, të cilat janë të destinuara për operacione në përputhje me aneksin IV B në shtetet që nuk janë të listuara në aneksin VII. Lëvizje të tilla ndërkufitare nuk do të ndalohen derisa mbetjet të jenë të karakterizuara si të rrezikshme sipas Konventës.

ANEKS VII

Palët dhe shtetet e tjera të cilat janë OECD, EC, “Litenshtein”.